



RADIO
TELEVISIONI
SHQIPTAR

KËSHILLI DREJTUES I RTSH
NR. 2715 PROT

Tiranë më 16.09.2020

VENDIM
NR. 28, date 16.09.2020

Në zbatim të nenit 102 pikat 2/ç dhe 12 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “ Për median audiovizive ne RSH”, nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 “ Për miratimin e Statutit të RTSH”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr 2151 prot, date 16.07.2020, dhe shkresën nr 2684 prot, datë 15.09.2020 mbi miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe Librin e Pagave të Drejtorisë së Arkivës të RTSH-së për vitin 2020, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij datë 16.09.2020 me votimin pro të 6 anëtarëve të pranishëm K.Traja, Xh.Aliu, Xh.Mato H.Haliti, S. Kumbaro, dhe A.Shegani;

VENDOSI:

I.Të miratojë disa ndryshime në Librin e Pagave dhe Strukturën Organizative të Drejtorisë së Arkivës të RTSH-së si më poshtë vijon:

NDRYSHIME NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE

- Në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Arkivit, një vend pune në emërtesën “Arkiviste” të ndryshojë në emërtesën “Arkiviste (me arsim të lartë)”.
- Në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Arkivit, të shtohen dy vende pune në emërtesën “Arkiviste (lajme)”.

NDRYSHIME NË LIBRIN E PAGAVE

- Të hiqet nga klasa e V e Librit të Pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të RTSH, emërtesa “Arkiviste e parë” dhe të kaloj në klasën e VI e ndryshuar “Arkiviste (me arsim të lartë)”.

Numri i vendeve të punës në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Arkivit të RTSH-së për vitin 2020 bëhet 21.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA